



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**"ISA BOLETINI"**  
**MITROVICË**

**Kryesuese e Senatit**  
Prof.asoc.dr. Merita Shala

Nr. Prot. 2991 Dt 21.12.2025

Në bazë të nenit 9, pika 5 dhe 6, të Rregullores 1670 të dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, Senati i Universitetit "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 19.12.2023, mori:

**VENDIM**

- I. Për aprovimin e propozimeve të njëjësive akademike për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, sipas konkursit me nr.prot.2067 i publikuar me dt.10.10.2023 dhe njoftimi mbi plotësim konkursi me nr.prot.2097 publikuar me dt.11.10.2023 të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë për vitin akademik 2023/2024, si në vijim:

**Fakulteti i Gjeoshkencave**

1. **Frashër Brahimaj** - mësimitdhënës për lëndët: Teknika e shpimit-plasjes në miniera, Plasjet speciale dhe masive, Sigurimi dhe kontrolli i cilësisë në proceset minerare, Teknologjia e shfrytëzimit sipërfaqësor.
2. **Jahir Gashi** - mësimitdhënës për lëndët: Mikroklima në minierë, Makinat minerare, Transporti dhe ngritja në minierë, Modelimi numerik në Gjeomekanikë.
3. **Albert Hyseni** - asistent për grup lëndësh nga Xehetaria.
4. **Diellza Habibaj** - asistent për lëndët: Kimia e përgjithshme, Kimia inorganike, Kimi.
5. **Astrit Shala** - asistent për grup lëndësh nga Gjeologjia.

**Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore**

1. **Anulohet konkursi për pozitën:** Një mësimitdhënës për lëndët: Matematika I dhe Matematika II. për shkak se askush nuk i plotëson kriteret.
2. **Arben Tahiri** - asistent për lëndët Fizika, Fizika I dhe II.
3. **Berat Sinani** - asistent për lëndët: Bazat e informatikës, Bazat e informatikës, Softueri aplikativ në Inxhinierinë mjedisore.
4. **Egzona Osmani** - asistent për grup lëndësh në Inxhinierinë Mjedisore.
5. **Arbnora Durmishaj** - asistent për grup lëndësh në Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore.

**Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike**

1. **Arbër Parduzi** - asistent për lëndët: Zhvillimi i aplikacioneve mobile, Bazat e shkencave kompjuterike, Përpunimi i big data .
2. **Anulohet konkursi për pozitën:** mësimitdhënës për lëndët: Zhvillimi i aplikacioneve mobile, Siguria e informacionit, Web programimi, për shkak se askush nuk i plotëson kriteret.

**Fakulteti Juridik**

1. **Anulohet konkursi për pozitën:** Një asistent për lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta administrative, E drejta kushtetuese, E drejta kushtetuese krahasuese, Procedura

administrative, E drejta e punës, për shkak të shkeljes së afateve të përcaktuara me Rregulloren 1670 dt. 28.09.2021.

2. **Albulena Uka** - asistent për grup lëndësh nga E drejta ndërkombëtare.
3. **Argjent Behrami** - asistent për grup lëndësh nga E drejta civile.

#### **Fakulteti Ekonomik**

1. **Afërdita Shabani** - mësimitdhënës për lëndën: Menaxhimi i resurseve humane.

#### **Fakulteti i Edukimit**

1. **Anduena Hajredinaj** - mësimitdhënës për lëndët: Matematika elementare I dhe II. Metodologji e mësimit të matematikës I dhe II.
2. **Hazir Elshani** - mësimitdhënës për lëndët: Psikologji e personalitetit, Psikologji edukimi, Puna më fëmijë të talentuar, Edukimi shëndetësor dhe mbrojtje e fëmijëve.
3. **Kristina Perkolaj** - mësimitdhënës për lëndët: Bazat e edukimit muzikor, Interpretim me instrumente.
4. **Anulohet konkursi** për pozitën: mësimitdhënës për lëndët: Gjuhë shqipe III (Sintaksa) me metodologji, Metodologji e gjuhës shqipe, për shkak se askush nuk i plotëson kriteret.
5. **Anulohet konkursi** për pozitën: Një mësimitdhënës për lëndën: TIK në arsimin Fillor, për shkak se nuk ka pasur kandidatë të interesuar.
6. **Leonora Bruçaj** - asistent për lëndët: Metodologji e leximit letrar, Teori e Letërsisë në arsimin fillor, Etnologji dhe letërsi popullore, Letërsi për fëmijë, Histori e letërsisë kombëtare.
7. **Anulohet konkursi** për pozitën: Një asistent për lëndët: Bazat e edukimit muzikor, Bazat e arsimit muzikor, Interpretim me instrumente, për shkak se nuk ka pasur kandidatë të interesuar.
8. **Blerthë Kaçiu** - asistent për lëndët: Edukim fizik me metodologji, Edukimi fizik në edukimin parashkollor.
9. **Anulohet konkursi** për pozitën: Një asistent për lëndët: Gjuhë shqipe III (Sintaksa) me metodologji, Metodologji e gjuhës shqipe, për shkak se nuk ka pasur kandidatë të interesuar.
10. **Anulohet konkursi** për pozitën: Një asistent për lëndën: TIK në arsimin Fillor, për shkak të shkeljes së procedurës administrative dhe afateve të përcaktuara me Rregulloren 1670 dt. 28.09.2021.

#### **Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Fakulteti i Tënologjisë Ushqimore**

1. **Bujar Rushiti** - mësimitdhënës për lëndët: Gjuhë angleze I dhe II

#### **Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Fakulteti i Tënologjisë Ushqimore, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Edukimit**

1. **Erëza Rushiti** - asistent për lëndët Gjuhë angleze I dhe II.
- II. Kandidatët të cilët janë përzgjedhur për angazhim në mësimitdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata varësisht prej fondit të orëve që posedojnë për vit akademik. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
- III. Kontratat e punës për stafin e propozuar për angazhim, sipas raporteve të komisioneve të njëjësive akademike, do të përpilohen sipas dispozitave ligjore. Nënshkrimi i kontratave për angazhim do të bëhet vetëm pas konstatimit të normës së orëve dhe grupeve që do të formohen pas pranimit të studentëve. Kontrata do të bëhet për vit akademik, ose një semestrale nëse

kandidati është i angazhuar vetëm për një semestër akademik, duke përfshirë edhe obligimet, që dalin nga procesi mësimor.

- IV. Bashkëpunëtorët e jashtëm të cilët kanë marrëdhënie pune, para nënshkrimit të kontratës duhet të sjellin dokumentin që dëshmon miratimin nga udhëheqësi më i lartë administrativ ku është i punësuar me kontratë primare (me kohë të plotë), konform nenit 4, pika 4.1, të Rregullores 09/2023 për shtesën funksionale.
- V. Për pozitat e anuluar, menaxhmenti i njësisë akademike obligohet të bëjë zgjidhje adekuate, sipas nenit 5, paragrafi 2 të Rregullores 1670, dt. 28.09.2021.
- VI. Dekanët e njësive akademike mbajnë përgjegjësi ligjore për rastet e konflikteve të interesit dhe nepotizmit për kandidatët e përzgjedhur.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Këshillë Juridike:** Kandidatët e pakënaqur mund të hapin konflikt administrativ në Gjykatën kompetente.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Menaxhmentit UIBM;
3. Fakulteteve;
4. Zyrës për çështje akademike;
5. Zyrtarit për paga;
6. Zyrës së personelit;

Prof.asoc.dr. Merita Shala

Kryesuesi e Senatit

